

VENDIM
Nr. 238, datë 18.5.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.792, DATË 24.12.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË DEKLARIMIT
TË PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.792, datë 24.12.1998, të ndryshohet: "Anëtarët e komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik, të shpërblehen për punën e kryer në masën 10 000 lekë në muaj. Kryetari i Komisionit shpërblehet në masën 15 për qind më shumë, kurse sekretari teknik 10 për qind më pak se anëtarët".

2. Pika 2 e vendimit nr.792, datë 24.12.1998, të ndryshohet: "Kuvendi të Republikës së Shqipërisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2000, i shtohet një fond prej 2 216 mijë lekësh, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për shpërblimin e anëtarëve të komisionit për vitet 1999 dhe 2000".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta